



Pranuar / Dorezuar Primljeno / Prodato Received / Delivered	18.11.2021	1	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojc a Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHM/MS/OK	5929/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.881/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2878/19 të Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 18.10.2021 kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.701/2019 të datës 08.11.2019 të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi Rruga “Hamzë Jashari”, Nr. 28/5B në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike “kompensim material” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.701/2019 e datës 08.11.2019 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ në bazë të Akt emërimit të datës 02.04.2012 është i punësuar në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në pozitën zyrtar i arsimit të mesëm të ulët.

Ankuesi më datë 28.05.2019 ka parashtruar kërkesë me Nr. reference: 1741 tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë për nivelizim të koeficientit duke u bazuar në katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil, mirëpo në bazë të shkresave të lëndës ankuesi nuk ka pranuar përgjigje nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm.

Ankuesi me datë 07.08.2019 ka parashtruar kërkesën me numër protokolli: 2521 për nivelizim të koeficientit në Ministrinë e Administratës Publike respektivisht në Departamenti e Administrimit të Shërbimit Civil (DASHC), mirëpo nuk ka pranuar asnjë përgjigje.

Ankuesi, përsëri me datë 03.10.2019 ka parashtruar kërkesën me numër protokoll: 3005 për nivelizim të koeficientit në Ministrinë e Administratës Publike respektivisht ne Departamenti e Administrimit të Shërbimit Civil (DASHC).

Ministria e Administratës Publike me datë 16.10.2019 dhe numër protokoll:3164 i ka kthyer një njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë se kërkesat për ngritje të koeficientit në kohën kur kanë ndodhur ndryshimet ligjore si pasoje e reformës në Administratën Publike nuk mund të bëhen pasi që është periudhë transitore dhe përgatitore e akteve nënligjore.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 16.10.2019 të Ministrisë së Administratës Publike ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 08.11.2019 dhe është protokolluar me numër protokoll 5288/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datën 14.11.2019 në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit. Me datë 21.11.2019 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritior administroj këto prova: Ankesën me numër protokoll 5288/2019 e datës 08.11.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesa e datës 07.08.2019; kërkesa e datës 28.05.2019; kërkesa për ngritje të koeficientit e datës 19.06.2019; Kërkesa e datës 03.10.2019; Njoftimi i datës 16.10.2019; Kërkesa për përgjigje ne ankesë e datës 14.11.2019; Përgjigja në ankesë e datës 21.11.2019 me numër protokoll:5473/2019; Akt emërimi i datës 02.04.2012; sipas Aktgjykimit A.nr.2878/19 të Gjykatës themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 18.10.2021; Njoftimin e datës 12.12.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesi është e jashtëafatshme, *sepe*:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi lidhur me kërkesën e tij për ngritje të koeficientit nga 7 (shtatë) në 8 (tetë), kërkesën e fundit e ka parashtruar më datë 28.05.2019 tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe pas kësaj kërkesë ankuesi ka vazhduar me kërkesa të tjera në Ministrinë të Administratës Publike edhe pse duke u bazuar në Rregulloren nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë në Shërbimin Civil përgjegjës për procedurat e ngritjes në karrierë të shërbyesve civil siç është kërkesa e ankuesit për ngritjen e koeficientit është institucioni punëdhënësin në rastin konkret Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, pasi që ankuesi në bazë të Akt emërimit të datës 04.05.2021 është i caktuar në pozitën “Zyrtar i arsimit të mesëm të ulët”, e kërkesa e tij për nivelizim të koeficientit në fakt është kërkesë për ngritje apo avancim pasi që koeficienti tetë (8) është i përcaktuar për “zyrtarët e lartë”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi kundër heshtjes së institucionit punëdhënës -respektivisht Sekretarit të Përgjithshëm si zyrtari më i lartë administrativ në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në këtë kuptim ankuesi është dashur që para parashtrimit të kërkesave të tjera në Ministrinë e Administratës Publike si dhe para parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të parashtroj fillimisht ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ashtu siç përcaktohet nën 8 paragrafin 2

të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: “Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”, pasi që fillimisht duhet shterë procedurat e brendshme të ankimit të përcaktuar me dispozitat e nenit 50 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike”, andaj duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 125 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: “heshtja administrative”)” si dhe nenit 127 paragrafi 1 i cili përcakton se: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”, andaj mbi këtë ankuesi ka humbur afatet e ankimit ndërlidhur me kërkesën e iniciuar të datës 28.05.2021 lidhur me ngritjen e koeficientit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit sipas nenit 10.1 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.881/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesi,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Arkivit të KPMSHCK- së.

